



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

**ADGJTHFR.nr.5/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Kryetari i Gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar më 20 prill 2022 nga mbrojtësi i të pandehurit F.T., av. Vllaznim Aliaj, me pretendimin për shkelje të procedurës, shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj F.D., në bazë të nenit 3, 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 17 maj 2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga pala – avokat Vllaznim Alija, ndaj gjyqtarës së Gjykatës Themelore në Ferizaj - F.D., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 20 prill 2022, nga Vllaznim Alija, avokat nga Ferizaj, mbrojtës i të pandehurit F.T. nga fshati ... - Komuna Ferizaj, ka pranuar ankesën ndaj gjyqtarës F.D., gjyqtare e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Parashtruesi i ankesës av. Vllaznim Alija në ankesën drejtuar autoritetit kompetent, pretendon se në çështjen penale e cila është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Ferizaj kundër të

pandehurit F.T., për shkak të dyshimit të se i njëjti ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 232 paragrafi 1 të KPRK-së, ka pas shkelje të dispozitave të KPPRK-së, Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe KEDNJ-së dhe atë: shkelja e dispozitave të nenit 191 paragrafi 2 të KPP-së e cila ka të bëjë me atë se mbrojtja kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit të evidentuar si: PP/II.nr.... të datë 13 prill 2022, e ka pranuar me datë 19 prill 2022 në ora 09:20 dhe atë me vet iniciativën e tij në zyrën e gjyqtarës që udhëheq me procedurën paraprake, gjithashtu edhe aktvendimin për vazhdimin e paraburgimit të evidentuar si: 2022:051025 të datë 14 prill 2022 e ka pranuar po të njëjtën datë, pra më 19 prill 2022 po ashtu në zyrën e gjyqtarës me vet iniciativë.

Mbrojtja duke mos qenë e informuar dhe pajisur me vendimet dhe kërkesën e prokurorisë për çështjen në fjalë, më 16 prill 2022 dita kur ka qenë afati i skadimit të paraburgimit duke mos pas njoftim adekuat për familjarët e të dyshuarit, për pasojë prindi i të dyshuarit me vet iniciativë ka shkuar në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan në ora 10:00 duke shpresuar se djali i tij do të lirohet ka pritur për dy orë dhe më pas ka kërkuar nga ai si mbrojtës sqarime se pse nuk lirohej djali i tij. I gjendur në këtë situatë (edhe pse ditë vikendi) mbrojtësi ka kuptuar përmes telefonatave se klientit të tij i ishte vazhduar paraburgimi edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë.

Nga të gjitha këto shkelje sipas pretendimeve të mbrojtësit, pasojat i bartë kush tjetër pos të dyshuarit, pasi i njëjti ka pranuar aktvendimin mbi vazhdimin e masës së paraburgimit qysh javën e kaluar, ndërsa afati për paraqitjen e ankesës ligjërisht është 24 orë, ndërsa mbrojtja e ka pranuar me vonesë, e gjithashtu me vonesë edhe kërkesën e prokurorisë pasi është pranuar pas pesë (5) ditëve.

Për mbrojtjen kjo nuk është rasti i vetëm pasi edhe më parë sipas pretendimeve të tij, ka pas probleme të tilla dhe atë në një rast tjetër, ku për pasojë i është kërkuar revokimi i autorizimit për shkak të këtyre shkeljeve në qasjen e vendimeve dhe kërkesave të prokurorisë dhe atë në lëndën 2021:263094, ku ka qenë mbrojtës sipas autorizimit për të akuzuarin A.Sh. nga Prishtina, mirëpo për atë çështje tani më i është revokuar autorizimi dhe më nuk do të merret me mbrojtjen e tij.

Parashtruesi i ankesës po ashtu ka kërkuar edhe sqarime se ku qëndron apo evidentohen shkeljet në rastin konkret pa aluduar në gjyqtaren e çështjes apo edhe administratën, andaj duke pas

parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti e të cilat janë cekur në ankesën e tij, konsideron se me të drejtë po i drejtohet kryetarit të gjykatës lidhur me shqetësimet e tyre duke shpresuar e njëkohësisht duke propozuar që ankesa e tyre të trajtohet.

Autoriteti kompetent konform nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ankesën e avokatit Villaznim Alija, e ka trajtuar si ankesë ndaj gjyqtarit, pasi nga përmbajtja e ankesës është vlerësuar se qëllimi i palës ka qenë që të paraqesë pretendime për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarës.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës duke u mbështetur në nenin 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 06/L-057, përmes shkresës ADGJTHFR.nr.5/22 të datë 22 prill 2022 ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës lidhur me ankesën e ankuesit.

Duke u mbështetur në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës si autoriteti kompetentë më 26 prill 2022 ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja ndaj të cilës është parashtruar ankesa, deklaratë të cilën më pas gjyqtarja në formë të shkruar e ka bërë më 28 prill 2022, e cila ka theksuar se:

- Më 18.03.2022 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, është pranuar kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për caktimin e masës së paraburgimit për të pandehurin F.T., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së.
- Më 19.03.2022 është mbajtur seanca dëgjimore dhe të pandehurit F.T. i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve nga data 17.03.2022 deri më 16.04.2022.
- Më 13.04.2022 në ora 14:26 Prokurori i shtetit ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit F.T..
- Më 14.04.2022, gjyqtarja e çështjes me aktvendimin 2022:050958, i ka vazhduar masën e paraburgimit të pandehurit edhe për dy muaj dhe atë nga data 14.04.2022 e deri më 13.06.2022 dhe se arsyeja e veprimit me urgjencë lidhur me këtë rast për vazhdimin e masës së paraburgimit me datë 14.04.2022, ka qenë fakti se gjyqtarja e çështjes më 15.04.2022, ka qenë e ftuar në cilësi të dëshmitares në një çështje penale në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda dhe atë në çështjen penale me

numër 2019:290789, ndërsa të pandehurit F.T. masa e paraburgimit do ti skadonte me datë 16.04.2022 në ora 10:00 (ditë e shtunë).

Gjyqtarja ka theksuar se aktvendimi për vazhdimin e masës së paraburgimit i datë 14.04.2022 është ngarkuar në sistemin SMIL (*Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve*) më 14.04.2022, ndërsa më 15.04.2022 në ora 08:35 në sistemin SMIL nga zyra e gjyqtares është krijuar detyra për dorëzimin e aktvendimit përmes sistemit SMIL. Gjyqtarja ka shtuar se avokati mbrojtës është paraqitur në zyrë më 19.04.2022, i cili e ka njoftuar gjykatën se është në dijeni se të mbrojturit të tij i është vazhduar masa e paraburgimit, duke theksuar se ende nuk e ka pranuar aktvendimin mbi vazhdimin e masës së paraburgimit, dhe pas këtij njoftimi, gjyqtarja ka deklaruar se avokatit mbrojtës Vllaznim Alija, i është dorëzuar personalisht aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit, por edhe kërkesa e prokurorisë për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Sa i përket revokimit të autorizimit për përfaqësim ndaj të pandehurit A.Sh., gjyqtarja ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e avokatit Vllaznim Alija dhe për ta vërtetuar këtë deklaratës së saj i ka bashkangjitur edhe kopjen e parashtresës për revokimin e autorizimit.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi ankesën-kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me pretendimet e cekura në ankesën e ankuesit e të përshkruara më lartë, shkresat e lëndës penale së procedurës paraprake penale, gjeti se ankesa-kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore është e pabazuar.

*“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve., shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...”*

Nga faktet e çështjes rezulton se Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm më 18 mars 2022 ka parashtruar kërkesë në Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal lidhur me caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarit

F.T., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së dhe lënda i është ndarë në punë gjyqtares së procedurës paraprake F.D., pasi e njëjta gjatë javës kur edhe është parashtruar kjo kërkesë ka qenë e caktuar si gjyqtare kujdestare.

Gjyqtarja e çështjes pas mbajtjes së seancës dëgjimore lidhur me kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit më 19 mars 2022 ka nxjerrë aktvendimin e evidentuar si: 2022:050958, me të cilin të pandehurit F.T. i ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve duke llogaritur nga koha e ndalimit të tij me 17 mars 2022, e cila masë do të zgjaste deri më 16 prill 2022.

Mbrojtësi i të pandehurit më 21 mars 2022 ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për caktimin e masës së paraburgimit, për çka Gjykata e Apelit e Kosovës me datë 29 mars 2022 ka nxjerrë aktvendimin PN.1.DP.nr..., me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj 2022:050958, të datë 19 mars 2022 e ka vërtetuar.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me datë 13 prill 2022 ka parashtruar kërkesë për vazhdimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurit, për çka gjyqtarja e procedurës paraprake më 14 prill 2022, ka nxjerrë aktvendimin 2022:051025, me të cilin të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë, aktvendim ky i cili përmes SMIL-it u është dorëzuar palëve, përkatësisht Qendrës së Paraburgimit në Gjilan përmes e-mailit me datë 15 prill 2022, ndërsa Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe mbrojtësit të të pandehurit përmes dorëzimit personal, e që rezulton se prokuroria aktvendimin e ka pranuar me datë 19 prill 2022, ndërsa mbrojtësi i të pandehurit av.Vllaznim Alija me datë 20 prill 2022 (ndërsa nga kjo fletë-dërgesë shihet se e njëjta është printuar me datë 19.04.2022 nga sistemi SMIL).

Kryetari i Gjykatës si Autoritet Kompetent vlerëson se pretendimet e parashtruesit të ankesës se gjyqtarja e çështjes ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale për faktin se të njëjtit nuk i është dorëzuar me kohë aktvendimi për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe se ky aktvendim mbi vazhdimin e masës së paraburgimit është marrë në bazë të kërkesës së prokurorisë dhe atë vetëm nën arsyetimin se ende nuk janë kthyer pajisjet elektronike nga Agjencia Kosovare e Forenzikës, ku janë dërguar për ekzaminim dhe se siç ka theksuar pala

ankuese, ky arsyetim i vetëm për vazhdimin e masës së paraburgimit është në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e parapara me dispozitat e nenit 187 të KPPRK-së, është i paqëndrueshëm, për faktin se mbrojtësi në aktvendimin mbi vazhdimin e masës së paraburgimit 2022:051025 të datë 14.04.2022 e ka pasur edhe këshillën juridike dhe afatin e paraqitjes së ankesës, dhe mundësinë për ti ngritur këto pretendime në ankesë, po ashtu edhe pretendimi tjetër i ankuesit për shkelje të dispozitave të nenit 191 paragrafi 2 të KPP-së, se mbrojtja kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. ... të datë 13.04.2022, e ka pranuar me datë 19.04.2022 në zyrën e gjyqtarës që udhëheq me procedurën paraprake, dhe e njëjta nuk i është dërguar me kohë, dhe për ti dhënë mundësi mbrojtësit që i njëjti të parashtoj kundërshtimin e tij lidhur me kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit, të dyja këto pretendime mbrojtësi gjithsesi ka mundur që ti theksoj në mjetin juridik drejtuar Gjykatës së Apelit, e cila sipas ligjit është autoritet për ti kontrolluar vendimet e shkallës së parë, andaj Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se për pretendimet e palëve për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat e instancave më të larta por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Për më tepër sa i përket theksimeve në ankesë për shkelje të dispozitave të nenit 191 paragrafi 2 të KPP-së, se mbrojtja kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr... të datë 13.04.2022, e ka pranuar me datë 19.04.2022 në zyrën e gjyqtarës që udhëheq me procedurën paraprake, autoriteti kompetent pas marrjes së deklaratës nga ana e gjyqtarës së çështjes por edhe vlerësimi të gjitha shkresave të lëndës ka konstatuar se kërkesa për vazhdimin e masës së paraburgimit në gjykatë është pranuar me datë 13 prill 2022 në ora 14:26 minuta kjo sipas SMIL-it dhe gjyqtarja të nesërmen pra me datë 14 prill 2022 ka nxjerrë aktvendimin për vazhdimin e masës paraburgimit ndaj të pandehurit këtë për shkak se skadimi i paraburgimit i caktuar me aktvendimin e datës 19 mars 2022 ka qenë deri me datë 16 prill 2022 e që i bie ditë vikendi, ndërsa me datë 15 prill 2022 ditë e premte gjyqtarja ka qenë e ftuar në cilësi të dëshmitares në një rast të evidentuar si 2019:290789 në Departamentin për Krime të Rënda të kësaj gjykate dhe për këtë shkak ka theksuar se i është dashur që të vendosë në mënyrë urgjente dhe pa vonesa lidhur kërkesën e prokurorisë për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Gjithashtu, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent vlerëson se nga veprimet e gjyqtarës së çështjes nuk konstatohen shkelje disiplinore të cilat janë përcaktuar në nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Rrjedhimisht, nga ajo që është cekur më lartë, nuk mund të konstatohet se gjyqtarja ka bërë shkelje disiplinore pasi nga faktet e konstatuara në shkresat e lëndës vijmë në përfundim se gjyqtarja ndaj të cilës është paraqitur ankesa-kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ka vepruar me efikasitet duke mos neglizhuar në asnjë moment trajtimin e kësaj lënde. Sipas shkresave të lëndës që ka pasur në dispozicion por edhe deklaratës së gjyqtarës, ka vlerësuar se data 14.04.2022, është data kur është ngarkuar në sistemin SMIL vendimi për vazhdimin e masës së paraburgimit, ndërsa data 15.04.2022 (ditë e premte) data kur është krijuar detyra në sistemin SMIL për dorëzimin e vendimit gjyqësor, për çka sipas rregullores për përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve dhe vendimeve të KGJK-së, të gjitha veprimet nga ana e zyrtarëve të gjykatës përfshirë edhe gjyqtarët duhet të bëhen përmes këtij sistemi, andaj duke pasur parasysh po ashtu faktin se data 18.04.2022 zyrtarisht ka qenë ditë pushimi për shkak të pashkëve katolik dhe administrata e gjykatës nuk ka punuar dhe vendimi mbi vazhdimin e masës së paraburgimit, avokatit mbrojtës i është dorëzuar me datë 19.04.2022 ditën e parë të punës pas festës zyrtare, dhe për këto arsye ka mundur të ketë vonesë në dorëzimin e vendimit por këto vonesa nuk mund të vlerësohen si lëshime nga ana e gjykatës dhe gjyqtarit, por për shkak se ditën e premte me datë 15.04.2022 është ngarkuar në sistemin SMIL vendimi për dorëzim, dita e shtunë datë 16.04.2022 dhe e dita e diel datë 17.04.2022 kanë qenë ditë vikendi pushim, ndërsa dita e hënë 18.04.2022 ka qenë festë zyrtare ditë pushimi (pashkët katolik), dhe për këtë arsye avokati mbrojtës vendimin e ka pranuar ditën e parë të punës me datë 19.04.2022 pas vikendit dhe pushimit për shkak të festës zyrtare.

Ndërsa, sa i përket pretendimit tjetër të ankuesit se për arsye të njëjta në një rast tjetër, si mbrojtës sipas autorizimit për të akuzuarin A.Sh., i është kërkuar revokimi i autorizimit për shkak të këtyre shkeljeve në qasje të vendimeve dhe kërkesave të Prokurorisë në lëndën 2021:263094, autoritetit kompetent përveç që vlerëson se ky pretendim është i pa bazuar, njëkohësisht vlerëson se si pretendim i ankuesit është edhe kundërthënës, pasi që në vetë parashtresën e avokatit mbrojtës të datë 06.04.2022, e titulluar “parashtresë mbi revokimin e autorizimit”, avokati mbrojtës, e ka njoftuar gjyqtaren e rastit se: “*si mbrojtës me autorizim i të*

*akuzuarit A.Sh., nga tani e tutje për të njëjtin nuk do të ofrojë mbrojtje, pasi që me datë 05.04.2021 nga babai i të akuzuarit Sh.Sh. nga Prishtina është bërë revokimi apo tërheqja e autorizimit, si dhe shkresave të lëndës”<sup>1</sup>, pra, vetë avokati në këtë parashtrësë askund nuk e ka theksuar arsyen e revokimit të autorizimit nga pala ashtu siç tani e ka cekur në këtë ankesë, pra se për shkak të shkeljeve dhe mos ofrimit të qasjes në vendime dhe kërkesa të Prokurorisë, andaj si i tillë ky pretendim është vlerësuar si pabazuar.*

Andaj bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar .

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**ADGJTHF.nr.5/22**

**17 maj 2022**

**Mustaf TAHIRI**

---

**Kryetar i Gjykatës**

### **Iu dërgohet:**

Vllzanim Aliaj – avokat, parashtruesi i ankesës

F.D. - Gjyqtare

Këshillit Gjyqësor i Kosovës

---

<sup>1</sup> Shih parashtrësën me numër 2021:263094 të datë 06.04.2022